





DYZET HADITHE RRETH
MUAJIT TË RAMAZANIT
DHE AGJËRIMIT

Tiranë, 2020



Titulli: *Dyzet hadithe rreth Muajit të Ramazanit dhe agjërimit*

I përzgjedhi dhe i përktheu: **Vullnet Merja**

Redaktoi: **Liseda Ramaj**

Përkujdesja kompjuterike & Kopertina:

Sabrie Feza

Botoi: Shoqata Flladi – Tiranë, 2020



Parathënie

Muaji i Ramazanit – ushqimi i zemrës,
i shpirtit dhe i mendjes

Allahu i Madhëruar thotë në
Kur'anin e Shenjtë: **“O ju që keni besuar!
Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u**



ishte urdhëruar atyre para jush, që të jeni të devotshëm.” (Sure “Bekare”, ajeti 183)

Mes ditëve dhe netëve të jetës, një melodi e këndshme lajmëron për ardhjen e një muaji të madh dhe përplot begati. Ajo melodi thotë: Erdhi muaji i bekuar i Ramazanit!

Muaji i Ramazanit është si shiu i butë i pranverës, i cili bie mbi shkretëtirën e thatë dhe të rreshkur. Të përpiqemi që shkretëtirën e shpirtit tonë ta vadisim me këtë shi jetëdhënës.

Pa dyshim që problemet dhe vështirësitë e jetës na kanë lodhur, na kanë mundur dhe na kanë shqetësuar. Muaji i

begatë i Ramazanit është një rast i veçantë dhe i volitshëm për të dalë nga pëlhura e lodhjes, e emundimit, e dëshpërimit dhe e shqetësimit, që na kanë mbuluar trupin dhe shpirtin. Megjithëse këto çaste të ndritura kalojnë shumë shpejt, ato i rikujtojnë njeriut marrëveshjen dhe besëlidhjen e tij me Allahun dhe rrugën e të jetuarit ashtu siç dëshiron Krijuesi.



Muaji i begatë i Ramazanit është përplot me çaste të bukura, të cilat nuk mund të shpjegohen me fjalë, por që duhen shijuar. Muaji i begatë i Ramazanit është qetësues i zemrave të mëkatarëve, të cilët duhet që me fletët e pendimit dhe të kërkimit të faljes të fluturojnë drejt qiellit të mëshirës e të faljes së Allahut. Ky muaj i



dashur qëndron pranë nesh disa ditë dhe disa netë dhe dalëngadalë largohet. Syfyret e ndritura, iftaret plot begati, krijojnë një ambient të mbushur plot spiritualitet dhe pastërti, duke mundësuar hapjen e një faqeje të re në jetë larg lodhjes, mërzitjes, dëshpërimit dhe shqetësimit.

Në këtë botë të mbushur me trazira, në të cilën dallgët e fuqishme të materializmit e përplasnin njeriun sa në një shkëmb te tjetri, njeriu ka nevojë më shumë se kurrë për t'u çliruar nga monotonia, të merret me veten e tij dhe të mendojë për qëllimet e krijimit dhe për përgjegjësitë që ka në këtë jetë dhe të shpëtojë nga përplasjet e dallgëve të materializmit shkatërrues.

Të gjithë e dimë se njeriu, përveç nevojave materiale, ka edhe nevoja dhe kërkesa të shumta shpirtërore. Nëse këto nevoja lihen në harresë, njeriu pëson dëm të pakompensueshëm. Njëri prej qëllimeve të agjërimit në muajin e bekuar të Ramazanit është që njeriu të çlirohet nga tufani i jetës materiale dhe të hyjë në mejdanin e jetës shpirtërore. Muaji i Ramazanit na mëson se si të përballemi me veprat e gabura e të këqija të cilat na çojnë në rrugë të gabuar dhe në shkatërrim. Ky muaj i begatë e shumëdimensional, i mundëson njeriut që në çdo vend të ndjejë me gjithë qënien e tij praninë e Krijuesit, Allahut të Gjithëditur e të Mirëinformuar. Në këtë muaj të bekuar, shpirti i njeriut





pastrohet me burimin e kthjellët të mëshirës së Allahut dhe njeriut i lind një kënaqësi të cilën nuk dëshiron ta ndërrojë me asnjë kënaqësi tjetër në këtë jetë.

Profetin Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pyetën se cila është vepra më mirë në këtë muaj? Ai u përgjigj: *“Puna më e mirë është ruajtja nga gjërat që i ka ndaluar Allahu.”* Pra, njeriu të mos e bëjë atë që e ka ndaluar Allahu i Madhëruar.

Tani që në muajin e Ramazanit është krijuar një mundësi e re që të rishikojmë mendimet, sjelljet dhe ndjenjat tona, atëherë ta shfrytëzojmë në maksimum këtë mundësi.

Një prej mundësive të përkryera në muajin e Ramazanit për të qetësuar shpirtin është leximi i Kur'anit të Shenjtë dhe ky lexim të jetë i shoqëruar me kuptim, arsyetim dhe zbatim, sepse Libri i Allahut, të cilit nuk i vjen e kota nga asnjë anë, është i pandryshuar dhe udhëzon në atë që është më e mira më e përkryera dhe më e dobishmja, siç thotë ajeti 9 i sures "Isra": **"Në të vërtetë, ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh."** Kur'ani i Shenjtë është ai që i mëson njeriut balancimin dhe ekuilibrin mes materiales dhe shpirtërores në çdo sferë të jetës. Prandaj, le të jetë Kur'ani





shoqëruesi ynë më i mirë në muajin e Ramazanit dhe në të gjithë jetën tonë!

Në ajete të ndryshme të Kur'anit, Allahu ka përmendur veçoritë e besimtarëve dhe të njerëzve punëmirë, duke premtuar se këto veçori e çojnë besimtarin drejt lumturisë dhe përparimit në fusha të ndryshme të jetës së tij. Gjithashtu, këto veçori e lartësojnë atë në Jetën Tjetër dhe e bëjnë prej banorëve të Xhenetit. Njëra prej veçorive të njerëzve punëmirë është besimi i tyre i patundur në Allahun e Plotfuqishëm. Në ajetin 9 të sures “Ankebut”, përmendet kushti për hyrjen në mesin e njerëzve të mirë, e ai është besimi dhe kryerja e veprave të mira. Ajeti thotë: **“Ata që besojnë dhe bëjnë**

vepra të mira, me siguri do t'i radhisim në mesin e të mirëve." Ndërsa në suren "Fusilet", ajeti 30 thuhet: **"Me të vërtetë, atyre që thonë: 'Zoti ynë është Allahu', e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin melekët (para vdekjes) e do t'u thonë: 'Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.'"**



Besimtarë të vërtetë janë ata njerëz të cilët kanë një zemër të mbushur me besim dhe me dashuri për Krijuesin. Ata, vazhdimisht e përmendin, e madhërojnë, e falënderojnë dhe e adhurojnë Atë. Falë besimit dhe bindjes që kanë në zemër ndaj Allahut Fuqiptotë, ata e ndjejnë veten e tyre të siguritë dhe ndjejnë një qetësi të paparë



në shpirtin dhe zemrën e tyre. Besimi, si një mbrojtës i fuqishëm, e ruan njeriun nga dëmtimet shpirtërore e morale dhe nga cytjet e shejtanit e të egos. Përvoja ka treguar se besimi në Allahun e Madhëruar i fal njeriut qetësi dhe siguri.

Nga këndvështrimi i njerëzve besimtarë, bota nuk është një përmbledhje elementesh të kotë dhe të pavlerë, por është një sistem, i cili ndjek një qëllim të caktuar. Sipas njeriut besimtar, Allahu Fuqiplotë është burimi i të gjitha të mirave dhe bukurive në gjithësi. Ai është i Gjithmëshirshëm, i Plotpushtetshëm. Është gjithmonë pranë robve të Tij dhe i dëgjon lutjet e tyre. Kjo ndjenjë, bën që besimtarët

të posedojnë shëndet më të mirë shpirtëror dhe psikik.

Ai njeri që nuk beson në ekzistencën e Allahut, pa dyshim që ndjen një boshllëk në brendinë e tij. Sigurisht, që kjo ndjenjë negative ndikon në sjelljet dhe në veprimet e tij.

Në këtë muaj të veçantë të përfitojmë sa më shumë nga sofrat e Allahut të Madhëruar, e cila përmban të gjitha ushqimet që i nevojiten zemrës, shpirtit, mendjes dhe ndërgjegjes që të fitojmë kënaqësinë e Allahut në të dy jetët. Nëpërmjet mësimave të tij të qarta e të larta, Kur'ani na tregon rrugën më të mirë për të arritur lumturinë në këtë Jetë dhe në Jetën Tjetër. Në suren "Haxh", ajeti 40,





thuhet: **“Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm.”**

Në suren “Ahzab”, ajetet 42-44 thuhet: **“O ju që keni besuar! Përmendeni shpesh Allahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje! Është Ai që ju bekon, ndërkohë që melekët e Tij luten për ju, me qëllim që Ai t’ju nxjerrë nga errësira në dritë. Ai është Mëshirues ndaj besimtarëve. Përsëndetja e tyre, kur ta takojnë Atë, është “Paqe”. Ai u ka përgatitur atyre shpërblim bujar.”**

O Allahu ynë! Me zemrën mbushur me besim dhe me shpresë në mëshirën Tënde të pafundme jemi gati që të përfitojmë sadopak nga kjo sofër që ke

përgatitur në këtë muaj të begatë! O Allahu ynë! Duart tona i ngremë drejt Teje në mënyrë që të na japësh atë që ne e meritojmë! O Allahu ynë! Të falënderojmë natë e ditë që na mundësove edhe njëherë të shijojmë ëmbëlsinë e pranisë së këtij muaji të bekuar!



Paqja qoftë mbi ty, o Muaj i mëshirës së Allahut! Paqja qoftë mbi ty, o sofrë e shtruar e Allahut! Paqja qoftë mbi ty, o Muaj që duam të të kemi pranë gjithmonë!

***Allahu zemrat na i qetësoftë dhe
adhurimet na i pranofhtë!***



DYZET HADITHE RRETH MUAJIT TË RAMAZANIT DHE AGJËRIMIT

Muaji i begatë i Ramazanit gëzon një pozitë të lartë dhe madhështore në fenë e drejtë islame dhe në sheriatin e pastër islam. Allahu i Madhëruar e përmend muajin e Ramazanit në Librin e Tij epokbërës, Kur’ani i Shenjtë dhe nuk ka përmend asnjë muaj tjetër përveç muajit të Ramazanit. Emri i këtij muaji madhështor

është përmendur një herë të vetme në Kur'an dhe pikërisht në ajetin 185 të suresa "Bekare" ku thuhet: **"Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t'jua lehtësojë dhe jo që t'jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta**





falënderoni Atë.” Kurse muajt e tjerë përmenden në formë përmbledhëse kur Kur’ani flet se numri i muajve është dybëdhjetë. Ai thotë: **“Vërtet, numri i muajve tek Allahu është dymbëdhjetë, sipas Librit të Allahut...”** (Sure “Teube”, ajeti 36).

Njohja e muajit të Ramazanit



Muaji i begatë i Ramazanit është muaji i nëntë i muajve hënor. Ai është muaji i Allahut, muaji i agjërimit, është padroni i të gjithë muajve dhe më i miri i tyre. Ai është muaji i durimit, muaji i vetëpërmbytjes, muaji i zbritjes së Kur'anit si dhe muaji i zbritjes së librave të tjerë qiellorë.

Islami nxit që muaji i shenjtë i Ramazanit të respektohet, të nderohet dhe të shfrytëzohen ditët dhe netët e tij me agjërime, falje namazesh, duke përmendur

Muajit të Ramazanit dhe agjërimit



Allahun, duke e falenderuar dhe duke e lartësuar Atë, duke u lutur e duke bërë sa më shumë punë të mira që të fitohet kënaqësia e Allahut të Madhëruar.

Të shumta janë hadithet që flasin për rëndësinë, mirësinë, dobitë dhe pozitën e lartë të muajit të Ramazanit dhe të agjërimit. Në këtë libër kemi përzgjedhur dyzet hadithe të ndryshme të ardhura nga Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe nga imamët e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!).

1- Dërgimi i salavateve për Profetin dhe familjen e tij



Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Kushdo që i shton salavatet për mua në muajin e Ramazanit, Allahu do t’ia rëndojë peshoren (e punëve të mira) në Ditën që lehtësohen peshat.”* Amalij i Sadukut, f. 155)



2- Pesë cilësitë e umetit islam në muajin e Ramazanit

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Ymetit tim i janë dhënë në muajin e Ramazanit pesë cilësi të cilat nuk i janë dhënë askujt më përpara. E para: Era e gojës së agjëruesit është më e këndshme tek Allahu se sa aroma e miskut. E dyta: Melekët kërkojnë falje për të (agjëruesin) deri sa të çelë iftarin. E treta: Prangosen në të shejtanët. E katërta: Marrin në të ato (shpërblime) që nuk i merrnin në muajt e tjerë.”* E pesta: Kur vjen nata e fundit e muajit të Ramazanit Allahu i Madhëruar i fal

Dyzet hadithe rreth

të gjithë ata. Një burrë i tha: O i dërguari i Allahut, a është Nata e Kadrit ajo? Profeti Muhamed i tha: Jo. A nuk i shikoni punëtorët se si i marin shpërblimet e tyre kur punojnë?
(Fadailu Esh'huri thelatheti, f. 90)





3- Melekët kërkojnë falje për agjëruesit

Imam Bakir (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Allahu ka vendosur melekë për agjëruesit. Ata kërkojnë falje për ata çdo ditë në muajin e Ramazanit deri në fund të tij. Çdo natë në iftar ata melekë u thërrasin agjëruesve: Myzhde, o robtë e Allahut! Ju ishit të uritur pak dhe do të ngopeni shumë. Të bekuar jeni! Kur vjen nata e fundit e muajit të Ramazanit, thërrasin: Myzhde, o robtë e Allahut! Ai ua ka falur juve gjynahet, ua ka pranuar pendimin, prandaj shikoni se si do të jeni pas Ramazanit.”



4- Largimi i shejtanëve

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka thënë shokëve të tij: “A t’ju lajmëroj për diçka, të cilën, nëse e mësoni, jua largon shejtanët ashtu siç largohet lindja nga perëndimi?” Ata i thanë: Po, o i Dërguari i Allahut. Ai u tha: “Agjërimi ia nxin atij fytyrën; sadakaja ia thyen atij shpinën; dashuria për hir të Allahut dhe bërja e punëve të mira e largojnë atë; kërkimi i faljes ia pret atij qafën. Për çdo gjë ka pastrues dhe pastruesi i trupave është agjërimi.” (Biharul Anuar, vëll. 96, f. 255)



5- Lutjet që nuk refuzohen

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Katër personave nuk u refuzohet lutja dhe atyre u hapen portat e qiellit dhe rrugëtojnë drejt Arshit: Lutja e prindit për fëmijën e tij; lutja e atij që i është bërë padrejtësi ndaj zullumqarit; lutja e atij që ka shkuar në umra (haxh), derisa të kthehet dhe lutja e agjëruesit derisa të çelë iftarin.”



6- Porta e Rejjanit

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Në Xhenet është një portë që quhet Er Rejjan. Në të nuk hyn askush tjetër përveç agjëruesve.*” (Uesailu Shiati: vëll. 7, f. 295, hadithi 310. Meanij El Akhabar, f. 116)



7- Duája e pranueshme

Imam Musa ibn Xhaferr Kadhim (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Duaja e agjëruesit në kohën e iftarit të tij është e pranueshme.”* (Biharul Anuar: vëll. 92, f. 255, hadithi 330.)



8- Agjërimi i shqisave

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Kur të agjërosh le të agjërojnë të dëgjuarit
tuaj, të shikuarit tuaj, floku yt dhe lëkura jote.”*
(El Kafij; vëll. 4, f. 87, hadithi 1)



9- Shpërblimi i agjërimit te Allahu

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë se në një hadith Kudsij Allahu i Madhëruar ka thënë: “Agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për atë.” (Uesailu Shiati: vëll. 7, f. 294, hadithi 15).



10- Agjërimi më i mirë

Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Agjërimi i zemrës është më i mirë se agjërimi i gjuhës dhe agjërimi i gjuhës është më i mirë se agjërimi i barkut.” (Gurerul Hikem: vëll. 1, f. 417, hadithi 80)



11- Agjërimi nga kënaqësitë e dynjasë

Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Agjërimi i nefsit nga kënaqësitë e dynjasë është agjërimi më i dobishëm.” (Gurerul Hikem: vëll. 1, f. 416, hadithi 64)



12- Agjërimi është xhihad

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Agjërimi në ditë të nxehta është xhihad.” (Biharul Anuar: vëll. 96, f. 257.)



13- Agjërimi është mburojë nga zjarri

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Agjërimi është mburojë nga zjarri.” (El Kafij: vëll. 4, f. 162.)



14- Agjërimi pastrues i trupit

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Për çdo gjë ka pastrues dhe pastruesi i trupave është agjërimi.” (El Kafij: vëll. 4, f. 62, hadithi 3)



15- Urdhëri për agjërime

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Janë urdhëruar për agjërime që të njohin dhimbjen, urinë dhe etjen që të argumentojnë (kuptojnë) varfërinë e Ahiretit.”* (Uesailu Shiati: vëll. 4, f. 4, hadithi 5. Ilelu Esh Sheraiu: f.10)



16- Agjërimi, provë për sinqeritetin

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Allahu e ka bërë detyrim agjërimin për të provuar
sinqeritetin e njerëzve.” (Nehxhul Belaga,
urtësia 252)



17- Barazimi i të pasurit me të varfërin

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Allahu e ka bërë detyrim agjërimitin që me atë
të barazohet i pasuri dhe i varfëri.”* (Men La
Jehdheruhul Fakijh: vëll, 2, f. 43, hadithi 1)



18- Sikur i gjithë viti të ishte agjërim

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Sikur robi ta dijë se çfarë përmban muaji i Ramazanit, do të uronte që i gjithë viti të ishte Ramazan.”* (Biharul Anuar: vëll. 93, f. 346.)



19- Muaji i Ramazanit, pranvera e Kur'anit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Për çdo gjë ka pranverë dhe pranvera e
Kur'anit është muaji i Ramazanit.” (Sherh
Usulul Kafij; vëll. 11, f. 75)



20- Portat e qiellit hapen në muajin e Ramazanit

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Portat e qiellit hapen në natën e parë të muajit të Ramazanit dhe mbyllen në natën e fundit të tij.”* (Biharul Anuar: vëll. 93, f. 344.)



21- Muaji i Ramazanit, muaji i mëshirës

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Ramazani është muaji fillimi i të cilët është mëshirë, mesi i tij është falje dhe fundi i tij është shpëtim nga Zjarri.”* (Biharul Anuar: vëll. 93, f. 342.)



22- Pajoja e mosagjërimit

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Kush e çel një ditë (me qëllim dhe pa arsye) në muajin e Ramazanit, shpirti i besimit del prej tij.” (Uesailu Shiati: vëll. 7, f. 181, hadithi 4 dhe 5. Men La Jehdheruhul Fakijh: vëll. 2, f. 73, hadithi 9)



23- Nata e Kadrit, kreu i vitit

Imam Bakir (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kreu i vitit është Nata e Kadrit. Në të shkruhet se çfarë do të ketë nga viti në vit.” (Uesailu Shiati: vëll, 7, f. 258, hadithi 8.)



24- Leximi i Kur'anit në muajin e Ramazanit

Imam Ali ibn Musa Riza (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Kush lexon në muajin e Ramazanit një ajet nga Libri i Allahut (Kur’ani), është sikur e ka lexuar të gjithë atë (Kur’anin) në muajt e tjerë.*” (Biharul Anuar: vëll. 93, f. 346.)



25- Ç' do të thotë agjërim?

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Agjërimi do të thotë të braktisësh të ndaluarat
njësoj siç e braktis njeriu ngrënien dhe pirjen.”*
(Biharul Anuar: vëll. 93, f. 249)



26- Agjërimi dhe ruajtja e gjymtyrëve

Fatime Zahraja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Çfarë i duhet agjërimi agjëruesit nëse nuk ka ruajtur gjuhën e tij, të dëgjuarit e tij, të shikuarit e tij dhe gjymtyrët e tij?” (Biharul Anuar: vëll. 93, f. 295.)



27- Ushqimi dhe pijet e Xhennetit

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Atë që agjërimi e ndalon nga ushqimi që e dëshiron, është e drejta e Allahut që ta ushqejë atë me ushqimin e Xhennetit dhe t’i japë të pijë prej pijeve të tij (Xhennetit).”* (Biharul Anuar: vëll. 93, f. 331.)



28- Të ngopurit në Ditën e Kijametit

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Lum ata që qëndrojnë të etur dhe të uritur për hir të Allahut. Ata do të jenë të ngopur në Ditën e Kiametit.*” (Uesailu Shiati: vëll, 7, f. 299, hadithi 20.)



29- Melekët u fshijnë fytyrat e agjëruesve

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kush agjëron një ditë për hir të Allahut në ditë të nxehtë dhe e godet etja, Allahu cakton për atë një mijë melek t'i fshijnë atij fytyrën dhe ta përgëzojnë derisa të çelë iftarin.”* (El Kafij: vëll. 4, f. 64, hadithi 8; Biharul Anuar: vëll. 93, f. 247.)



30- Dimri, pranvera e besimtarit

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Dimri është pranvera e besimtarit. Në të zgjatet nata dhe ai e shfrytëzon atë me falje namazi; dhe shkurton dita dhe ai e shfrytëzon atë me agjërim.”* (Uesailu Shiati: vëll, 7, f. 302, hadithi 30.)



31- Agjërimi është pengesë ndaj të këqijave

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Agjërimi nuk është të braktisësh të ngrënit dhe të pirët, por atë e ka bërë Allahu perde dhe pengesë ndaj të këqijave në thënie e në vepra.”



32- Të ushqyerit e agjëruesit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Kush e ushqen një agjërues ka të njëjtin
shpërblim si ai (si shpërblimi i agjëruesit).”
(El Kafij: vëll. 4, f. 68, hadithi 1)



33- Agjërimi është moral

Transmetohet se një ditë Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dëgjoji një grua, e cila agjëronte, e ajo po shante dhe po ofendonte shërbyesën e saj. Profeti urdhëroi të sillnin ushqim dhe ia sollën. Ai iu drejtua gruas dhe i tha: Ha! Ajo i tha: Unë po agjëroj. Ai i tha: *“Si mund të jesh me agjërim ndërkohë që shave dhe ofendove shërbyesën tënde. Vërtet, agjërimi nuk është të braktisësh të ngrënit dhe të pirët.”* (Biharul Anuar: vëll. 93, f. 292.)



34- Allahu ia fal gjynahet e shkuara agjëruesit

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Kush e agjëron muajin e Ramazanit dhe e ruan nderin e tij, e ruan gjuhën e tij, nuk i lëndon njerëzit dhe nuk i bën keq atyre, Allahu ia fal atij gjynahet e shkuara e të ardhshme, e mbron nga Zjarri dhe e fut në Xhenet.”*



35- Shtatë veçantitë e agjëruesit

Është transmetuar nga Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ka thënë: “Ai besimtar që e agjëron muajin e Ramazanit me bindje, Allahu do t’i japë atij shtatë veçanti:

E para: Harami shkrihet nga trupi i tij.

E dyta: Nuk largohet nga mëshira e Allahut.

E treta: I falet gabimi i babait të tij Ademit (Paqja goftë mbi të!).

E katërta: Allahu ia lehtëson vështirësitë në momentin e vdekjes.

E pesta: Është i sigurtë nga uria dhe etja në Ditën e Kiametit.

Dyzet hadithe rreth

E gjashta: Allahu e shpëton nga zjarri.

*E Shtata: Allahu e ushqen me të mirat e
Xhennetit*

(Men La Jehdheruhul Fakijh: vëll. 2, f.74)





36- Agjërimi është pastrues nga gjynahet

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Muaji i Ramazanit është muaji që Allahu e ka bërë detyrë agjërimitin e tij. Kushdo që e agjëron këtë muaj me besim dhe me bindje, ai do të pastrohet nga gjynahet dhe do të jetë si dita që e lindi nëna e tij.”* (Et Tehdhijb: vëll. 4, kapitulli i agjërimit, kreu Ferdu Sijam, hadithi 2)



37- Muaji i Ramazanit muaji i faljes dhe i shpëtimit nga zjarri

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Kur vjen nata pasardhëse (nata e dytë), Allahu fal më shumë se në natën e parë; kur vjen nata pasardhëse Allahu e shton numrin e atyre që i shpëton nga Zjarri. Dhe kur vjen nata e fundit e muajit të Ramazanit, Allahu e shton numrin e shpëtuesve njësoj siç shpëtonte në çdo natë.” (El Ikbalu: vëll. 1, f. 28)



38- Emri Ramazan është prej emrave të Allahut

Transmetohet nga imam Bakir (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Mos thoni ky është Ramazani, as mos thoni iku Ramazani, as mos thoni erdhi Ramazani, sepse Ramazani është emër prej emrave të Allahut të Madhëruar, i cili as nuk vjen e as nuk ikën. Porse shkon e vjen vetëm i paqëndrueshmi. Por, thoni muaji i Ramazanit, sepse fjala **muaj** është bashkëngjitje për emrin (Ramazan) dhe ky është emër i Allahut të Madhëruar. Ai është muaji në të cilin është zbritur Kur’ani dhe e ka bërë atë shembull dhe festë.” (El Kafij: vëll. 4, f. 69.)



39- Muaji i Ramazanit, muaji veçantë

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*“Asnjë muaj nuk i ngjan muajit të Ramazanit.
Mund të thuash se ai ka të drejta dhe shenjtëri
më shumë se sa namazi.”* (El Kafij: vëll. 2, f.
618.)



40- Sa të vështira janë kushtet e tij, o Xhabir!

Një ditë Profeti *Muhamed* (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i ka thënë Xhabir ibn Abdulla El Ensarijut: “O Xhabir! Ky është muaji i Ramazanit. Ai që agjëron ditën e tij, çohet e falet në natën e tij, e ruan barkun e tij, nderin e tij dhe gjuhën e tij, ai do të pastrohet nga gjynahet e tij ashtu siç del prej muajit.” Xhabiri i tha: Sa hadith i bukur, o i Dërguari i Allahut! Profeti i tha: “Sa të vështira janë kushtet e tij, o Xhabir!” (El Kafij i Kulejnit: vëll. 4, f. 87, kreu Adabu Saumi, hadithi 2.)



Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Parathënie..... | 5 |
| Muaji i Ramazanit - ushqimi i zemrës, i shpirtit dhe i mendjes..... | 5 |
| Dyzet hadithe rreth muajit të Ramazanit dhe agjërimit..... | 18 |
| Njohja e muajit të Ramazanit..... | 21 |
| 1- Dërgimi i salavateve për Profetin dhe familjen e tij..... | 23 |
| 2- Pesë cilësitë e umetit islam në muajin e Ramazanit..... | 24 |
| 3- Melekët kërkojnë falje për agjëruesit...26 | |

Muajit të Ramazanit dhe agjërimit



| | |
|--|----|
| 4- Largimi i shejtanëve..... | 27 |
| 5- Lutjet që nuk refuzohen..... | 28 |
| 6- Porta e Rejjanit..... | 29 |
| 7- Duája e pranueshme..... | 30 |
| 8- Agjërimi i shqisave..... | 31 |
| 9- Shpërblimi i agjërimit te Allahu..... | 32 |
| 10- Agjërimi më i mire..... | 33 |
| 11- Agjërimi nga kënaqësitë e dynjasë.... | 34 |
| 12- Agjërimi është xhihad..... | 35 |
| 13- Agjërimi është mburojë nga zjarri..... | 36 |
| 14- Agjërimi pastrues i trupit..... | 37 |
| 15- Urdhëri për agjërime..... | 38 |
| 16- Agjërimi, provë për sinqeritetin..... | 39 |
| 17- Barazimi i të pasurit me të varfërin... | 40 |
| 18- Sikur i gjithë viti të ishte agjërime..... | 41 |

| | |
|---|----|
| 19- Muaji i Ramazanit, pranvera e Kur'anit..... | 42 |
| 20- Portat e qiellit hapen në muajin e Ramazanit..... | 43 |
| 21- Muaji i Ramazanit, muaji i mëshirës.... | 44 |
| 22- Pasoja e mosagjërimit..... | 45 |
| 23- Nata e Kadrit, kreu i vitit..... | 46 |
| 24- Leximi i Kur'anit në muajin e Ramazanit..... | 47 |
| 25- Ç' do të thotë agjërim?..... | 48 |
| 26- Agjërimi dhe ruajtja e gjymtyrëve.... | 49 |
| 27- Ushqimi dhe pijet e Xhennetit..... | 50 |
| 28- Të ngopurit në Ditën e Kijametit..... | 51 |
| 29- Melekët u fshijnë fytyrat e agjëruesve.... | 52 |
| 30- Dimri, pranvera e besimtarit..... | 53 |



Muajit të Ramazanit dhe agjërimit



| | |
|--|----|
| 31- Agjërimi është pengesë ndaj të këqijave..... | 54 |
| 32- Të ushqyerit e agjëruesit..... | 55 |
| 33- Agjërimi është moral..... | 56 |
| 34- Allahu ia fal gjynahet e shkuara agjëruesit..... | 57 |
| 35- Shtatë veçantitë e agjëruesit..... | 58 |
| 36- Agjërimi është pastrues nga gjynahet..... | 60 |
| 37- Muaji i Ramazanit muaji i faljes dhe i shpëtimit nga zjarri..... | 61 |
| 38- Emri Ramazan është prej emrave të Allahut..... | 62 |
| 39- Muaji i Ramazanit, muaj i veçantë..... | 63 |
| 40- Sa të vështira janë kushtet e tij, o Xhabir!..... | 64 |



اسم الكتاب: اربعون حديث عن شهر رمضان و الصيام

ترجمة الأحاديث: الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحیح الاذنی: لیسدا رامای

التصحیح اللغوی: ویولسا کارای

الإخراج النهائي: صبریه فزا

الغلاف: صبریه فزا

الناشر: جمعیت نسیم

تیرانا: 2020